



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 123

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA
PARTIA “LËVIZJA E RE” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL
2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

“Partia Lëvizja e Re” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, “Partia Lëvizja e Re” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zonat zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të “Partisë Lëvizja e Re” dhe dokumentacionin bashkëngjitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;



3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë dhe me pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke mosrespektuar kuotën gjinore.
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë;
8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkalluar numrin e kërkuar me 3 kandidatë.
9. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8, z. Eneo Bekteshi, numër rendor 9, zj. Sonila Kikri, dhe numër rendor 12, z. Edmond Murja për zonën zgjedhore, **Qarku Durrës**, pika 4 rezulton e paplotësuar.
10. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 3, zj. Evisa Nano, për zonën zgjedhore, **Qarku Elbasan**, pika 4 rezulton e paplotësuar.
11. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 11, z. Renato Bezati, për zonën zgjedhore, **Qarku Fier**, pika 8 rezulton e paplotësuar.
12. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 4, z. Rigest Lusha, për zonën zgjedhore, **Qarku Gjirokastrë**, nuk korrespondon emri në listën shumemërore me formularin e vetëdeklarimit.
13. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 10, z. Ernes Manoku, për zonën zgjedhore, **Qarku Korçë**, në faqen e dytë mungon nënshkrimi.
14. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 22, zj. Violeta Bonaj, për zonën zgjedhore, **Qarku Tiranë**, pika 5, rezulton e paplotësuar.



15. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 2, zj. Alketa Hadëraj, për zonën zgjedhore, **Qarku Vlorë**, pika 8 rezulton e paplotësuar.

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor “Partia Lëvizja e Re”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V E N D O S :

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të “Partisë Lëvizja e Re”, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

